

**KONTRATE**  
**PER THEMELIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"RUNJA" SH.P.K. Bulqizë**



Personat qe firmosin me poshte :

**Hane DODA** e bija e Jasharit dhe e Faries lindur ne Krajke, Diber me 20 dhjetor 1963 dhe banuese ne Peshkopi, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me Çertifikaten e Lindjes me fotografi me Nr 22/5-2 leshuar me 05.05.1998 nga zyra e Gjendjes Civile Peshkopi

**Shyqyrie GJIKA** e bija e Saliut dhe e Sheqeres lindur ne Ternove, Bulqize me 20 qershor 1970 dhe banuese ne Bulqize, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me Çertifikaten e Lindjes me fotografi me Nr.2 , leshuar me 07.05.1998 nga zyra e Gjendjes Civile Zerqan.

Kane hartuar si me poshte vijon **Kontraten e Themelimit** te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar .

**Neni 1**

Personat fizike te superpermendur , me vullnetin e tyre te lire dhe ne pajtim me legjislacionin shqiptar ne fuqi rane dakort te krijojne shoqerine e perbashket me pergjegjesi te kufizuar me emertimin

**"RUNJA" SH.P.K. Bulqizë**

Selia e shoqerise ndodhet ne **Bulqizë**,

Ortaket e shoqerise do te jene *zn.Shyqyrie GJIKA & zn.Hane DODA.*

Administratore e shoqerise do te jete *zn.Shyqyrie GJIKA*

Drejtuues teknik i shoqerise do te jete *z.Hysni BUCI*

Shoqeria ka te drejte *te krijoje filialet e saj brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe* qe te cmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

**Neni 2**

Shoqeria **"RUNJA" SH.P.K. Bulqizë** gezon statusin e personit juridik . Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj *kontrate* , *statutit* te saj dhe *legjislacionit* shqiptar ne fuqi. Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj .

**Neni 3**

Veprimtaria e shoqerise si person juridik fillon me aprovimin e krijimit te saj nga organet kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe *mbi 10 vjet.*

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, ne qofte se ortakët me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjasin kete afat .

Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, ne qofte se per kate marrin vendim unanim te gjithë ortakët qe bejne pjese ne kete shoqeri



#### Neni 4

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj :

#### Import - eksport si dhe tregtim me shumicë e pakicë të

- \*tuba e gypa metalike e plastike të dimensioneve të ndryshme
- \*kablo elektrik dhe telefonik të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme
- \*metale si; çelik, hekur bronx, bakër, alumin etj. lëndë e parë, shufra, profile si dhe prodhime të tjera metalike, të llojeve e tipave të ndryshëm, etj
- \*pillaka dhe paisje hidraulike, hidrosanitare e termosanitare,
- \*elektroda dhe tela, të llojeve e tipave të ndryshëm
- \*lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to, mobilieve dhe elementeve të tyre
- \*mailrave industriulë, lëndëve të para e materialeve të ndërtimit si dhe makineri ndërtimi e pjesë këmbimi për to
- \*te automjeteve dhe pjesëve të këmbimit për to
- \*duhan, cigare mailra ushqimore, bujqësor e blektoral
- \*konfeksione e tekstile, këpucë të çdo lloji,
- \*galanteri dhe artikuj lekure si dhe lende të para për industrinë e përpunimit të lekures
- \*mjete transporti e pjesë këmbimi për to,
- \*tregtim karburanti e nenproduktet e naftës,
- \*paisjeve elektroshpërndaje, elektrike, elektroteknike dhe elektronike si dhe pjesë këmbimi për to, paisje kancelarie,
- \*artikujve për higjienën e trupit; e artikujve të kozmetikës, dentare, optike, higjino sanitare dhe paisje e vegjëljesh për shërbimet human e veterinar,
- \*te ferokromit, koncentratit dhe mineralit të kromit,
- \*plehra kimike e inorganike për bujqësinë si dhe artikuj e lende të para për industrinë kimike e atë plastike,
- \*aktivitete prodhuese, përpunuese dhe shërbime bazuar në lëndët e para të vendit e të importit

- \*aktivitetet minerar - nxjerrje, përpunim, transport dhe ndërmjetësim për tregje të mineralit të kromit, prodhim koncentratit, shpime nëntokesore
- \*permirësimi i pyjeve dhe shfrytëzimi dhe përpunim i lëndës drusore, mbrojtja dhe permirësimi i livadheve dhe kullotave, mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e demtuesit, permirësimin e flores e faunës së zonave,
- \*grumbullim dhe përpunim të artikujve bujqësor e blektoral, të bimëve medicinale e eterovajore,
- \*prodhime druaresh, dymesh, grilash metalika (duralumioni) e plastike
- \*prodhim materialesh inerte dhe të ndërtimit si dhe parafabrikateve të ndërtimit
- \*montime të impianteve dhe makinerive ngritëse e transportuese (si teleferike e të tjera të kësaj natyre)
- \*punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal, ndërtim impiantesh elektrike, telefonike
- \*ashensorësh, shkallë të ndryshme levizëse dhe transportiere, mirëmbajtje e tyre
- \*radioreleje e radiotelevizive dhe mirëmbajtja e tyre
- \*ndërtim dhe montim të impianteve për prodhimin e energjisë nga burime të ndryshme impiante elektrike për centralët dhe prodhim të transformatoreve, montim i linjave të tensionit të lartë dhe të ulët,
- \*servise për automjete të llojeve dhe tonazheve të ndryshme
- \*bar, restorant, hotelerie
- \*shërbime transporti për mallra e udhëtarë për nevojat e prodhimit e për të tretë
- \*media elektronike
- \*ndërmjetësim, dhe veprime konsensionare, për shitje, blerje, dhenie me qera etj
- \*aktivitet ndërtimor në - kat 1
- punime dheu, murature, betoni, b/arme të zakonshme, punime shembjesh



- kat 2 / *ndertime civile , industriale, turistike, bujqesore etj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.*
- kat 3 / *punime restaurimi*
- kat 7 / *mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal*

#### Neni 5

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie do te jete **100.000 (njqindmije)leke** . Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar , shlyer plotesisht dhe jane shperndar ndermjet ortakeve si me poshte:

- |                  |                             |         |
|------------------|-----------------------------|---------|
| 1. Shyqyrie GJKA | 50.000 leke (pesedhjetmije) | ose 50% |
| 2. Ilanc DODA    | 50.000 leke (pesedhjetmije) | ose 50% |

Shuma e kapitalit themeltar eshte **depozituar** ne Banken Kombetare Tregtare Dega Bulqizë. nga ortakët e shoqerise **ne nje llogarin me Nr. 1877/114/02 te hapur ne emer te shoqerise** me pergjegjesi te kufizuar "RUNJA" SH.P.K. Bulqizë para fillimit te aktivitetit te saj .

#### Neni 6

Fitimet neto qe do te realizohen nga veprimtaria e kesaj shoqerie do te **ndahen** ndermjet ortakeve **ne proporcion** me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar

#### Neni 7

Per **detyrimet** qe do te krijohen ndaj te treteve gjate aktivitetit te kesaj shoqerie , kjo shoqeri do te **pergjigjet vetem me kapitalin e saj**

Ortakët nuk mbajne pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurite e tyre qe nuk bejne pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie .

#### Neni 8

Nuk mund te pranohet ne shoqeri si ortak nje person i trete pa pelqimin unanim te ortakeve.

Nuk mund te hiqet dore nga kjo kontrate ne menyre te njeaneshme pa pelqimin e ortakeve te tjere.

Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij ne kete shoqeri eshte i detyruar qe oferten e tij per shitje t'ia beje ortakëve te tjere dhe ne qofte se keta te fundit nuk pranojne blerjen ose nuk japin pergjigje **brendë 30 diteve** nga data e berjes se ofertes , atehere ortakë eshte i lire te disponoje pjesen e tij .

#### Neni 9

Ortakët jane te detyruar te ruajne karakterin konfidencial te aktivitetit te shoqerise .

Ortaku qe shkel detyrimin e me siperm dhe nga kjo shkelje i shkaktohet dem shoqerise , eshte i detyruar te shperblej demin

#### Neni 10

Marredheniet e punes ne shoqeri ose ne filialet e saj rregullohen nepermjet **kontrates kolektive te punes** .

## Neni 11

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen *ne marreveshje* midis tyre . Ne qofte se ortaket nuk merren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim *organ kompetent* per zgjidhjen e tyre *Shkete Gjykatore e Rrethit Bulqizë*.

## Neni 12

Dispozita te hollësishme per organizimin e shoqerise percaktohen *ne Statutin* e saj.

*Ortaket pasi lexuan me vemendje kontraten e mesiperme dhe e gjeten konform vullnetit te tyre e nenshkruan rregullisht .*

## ORTAKET

zn. Shyqyrie GJIKAJ  
*[Signature]*

zn. Hane DODA  
*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
ZYRA E NOTERISE  
TIRANE

Nr. *1837* Rep  
Nr. *485* Kol

## VERTETIM

Sot me date *13.05* 1998, ne Zyren e Noterise Tirane, u paraqiten personalisht para meje ortaket e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

"RUNJA" SH.P.K. Bulqizë  
Shyqyrie GJIKAJ & Hane DODA

te pajohura prej meje per identitetin e te cilave u sigurova nga leternjoftimet personale, madhore dhe me notesi te plote juridike e per te vepruar, te cilat me deklaruan se **Kontrata e Themelimit** si mesiperme eshte perpiluar sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe une noterja e nenshkrova ate ne baze te ligjit.

## NOTERE

*Addiano Muri*





# STATUTI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### "RUNJA" SH.P.K. Bulqizë.

Personat që firmosin me poshte .

**Hane DODA** e bija e Jasharit dhe e Faries lindur ne Krajke, Diber me 20 dhjetor 1963 dhe banuese ne Peshkopi. madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar me Çertifikaten e Lindjes me fotografi me Nr.22/5-2 , leshuar me 05.05.1998 nga zyra e Gjendjes Civile Peshkopi

**Shyqyrie GJITKA** e bija e Saliut dhe e Sheqeres lindur ne Ternove,Bulqize me 20 qershor 1970 dhe banuese ne Bulqize. madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar. identifikuar me Çertifikaten e Lindjes me fotografi me Nr.2 , leshuar me 07.05.1998 nga zyra e Gjendjes Civile Zerqan.

Kane hartuar si me poshte vijon **Statutin** e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar te cilen ne baze te **Kontrates se Themelimit** kane vendosurta themelojne :

### KREU I

#### FORMA , EMERTIMI , OBJEKTI , SELLA , KOHEZGJATJA .

##### Neni 1

Krijohet nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila e ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe ne menyre te vecante me ligjin Nr.7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate ushtrimit te veprimtarise se shoqerise si dhe me dispozitat e ketij Statutin

##### Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte **"RUNJA" SH.P.K. Bulqizë**

##### Neni 3

Shoqeria do te kete objekt te veprimtarise se saj :

**\* Import - eksport si dhe tregtim me shumicë e pakicë të**

***\*\*tuba e gypa metalike e plastke të dimensioneve të ndryshme***

***\*\*kabllo elektrik dhe telefonik të llojeve dhe dimensioneve të ndryshme***

***\*\*metale si; çelik, hekur bronx, bakër, alumin etj. lëndë e parë, shufra, profile si dhe prodhime te tjera metalike, të llojeve e tipave të ndryshëm, etj***

***\*\*pllaka dhe paisje hidraulike , hidrosanitare e termosanitare,***

***\*\*elektroda dhe tela, të llojeve e tipave të ndryshëm***

***\*\*lëndëve të para për prodhimin e mobilieve, makinerive për prodhimin dhe përpunimin e lëndës drusore si dhe pjesë këmbimi për to, mobilieve dhe elementeve të tyre***

***\*\*mallrave industrialë, lëndëve të para e materialeve të ndërtimit si dhe makineri ndërtimi e pjesë këmbimi për to***



- \*\* te automjeteve dhe pjeseve te kembimit per to
- \*\* duhan, cigare mallra ushqimorë, bujqesor e blektoral
- \*\* konfeksione e tekstile , këpucë të çdo lloji,
- \*\* gatantëri dhe artikuj lekure si dhe lende te pare per industrine e perpunimit te lekures
- \*\* hyrje transporti e pjesë këmbimi për to,
- \*\* fletim karburanti e nenproduktet e naftes,
- \*\* pajisjeve elektroshtëpiake, elektrike, elektroteknike dhe elektronike si dhe pjesë këmbimi për to, paisje kancelarie,
- \*\* e artikujve per higjenen e trupit; e artikujve te kozmetikes, dentare, optike, higjino sanitare dhe paisje e vegla njeksore te sherbimit human e veterinar.
- \*\* te ferokromit, koncentratit dhe mineralit te kromit.
- \*\* plehra kimike e inorganike per bujqesine si dhe artikuj e lende te para per industrine kimike e ate plastike.

**\*aktivitete prodhuese , përpunuese dhe shërbime bazuar ne lendet e para te vendit e te importit**

- \*\* aktivitet minerar - nxjerrje, perpunim, transport dhe ndermjetesim per tregje te mineralit te kromit, prodhim koncentratit , shpime nentokesore
- \*\*permiresimi i pyjeve dhe shfrytezimi dhe perpunim i lendes drusore, mbrojtja dhe permiresimi i livadheve dhe kullotave, mbrojtjen e pyjeve nga zjarri e demtuesit, permiresimin e flores e faunes se zonave.
- \*\* grumbullim dhe perpunim te artikujve bujqesor e blektoral. te bimeve medicinale e eterovajore.
- \*\* prodhime dritaresh, dyersh, grilash metalika (duralumioni) e plastike
- \*\* prodhim materialesh inerte dhe të ndërtimit si dhe parafabrikateve te ndertimit
- \*\*montime te impianteve dhe makinerive ngritese e transportuese (si teleferike e te tjera te kesaj natyre ) ashensoresh, shkalle te ndryshme levizese dhe transportiere, mirembajtje e tyre
- \*\*punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal, ndertim impiantesh elektrike, telefonike radioreleje e radiotelevizive dhe mirembajtja e tyre
- \*\*ndertim dhe montim te impianteve per prodhimin e energjise nga burime te ndryshme impiante elektrike per centralet dhe prodhim te transformatoreve , montim i linjave te tensionit te larte dhe te ulet, linjave te ndriqimit dhe aparaturave elektrike, mirembajtja e tyre .
- \*\* servise per automjete te llojeve dhe tonazheve te ndryshme
- \*\* bar, restorant, hotelerie
- \*\* sherbime transporti per mallra e udhetare per nevojat e prodhimit e per te trete
- \*\*media elektronike
- \*\* ndermjetesime, dhe veprime koncensionare, per shitje, blerje, dhenie me qera etj
- \*\*aktivitet ndertimor ne - kat 1 punime dheu , murature, betoni, b/arme te zakonshme, punime shembjesh
- kat 2 ndertime civile , industriale, turistike, bujqesore etj dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to.
- kat 3 punime restaurimi
- kat 7 mirembajtje e punime sherbimi te zakonshme te sistemit komunal

**Neni 4**

Selia e shoqerise ndodhet ne , Bulqizë

Transferimi i selise se shoqerise behet me miratimin unanim te ortakeve .

## Neni 5

Kohezzgatja e shoqerise do te jete *mbi 10 vjet*

## Neni 6

Shoqeria ka vulen e saje ne forme e percaktuar nga ortaket, ku do te jete e shkruar Shoqeria Private "RUNJA" SH.P.K. Bulqizë

## KREU II

### KAPITALI THEMELTAR , KONTRIBUTET , PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

## Neni 7

Kapitali themeltar do te jete *100.000 (njqindmije) leke*. Kapitali themeltar eshte *i ndare ne 100 pjese* plotesisht te shlyera *me vlere 1000 leke secila* te renditura sipas numrit te serise nga 1 deri ne 100.

Fondet qe rrjedhin nga shlyerja e pjeseve jane *depozituar* ne Banken Kombetare Tregtare Dega Bulqizë, nga ortaket e shoqerise *ne nje llogarin me Nr. 1877/114/02 te hapur ne emer te shoqerise* me pergjegjesi te kufizuar "RUNJA" SH.P.K. Bulqizë para fillimit te aktivitetit te saj .

Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet pjeseve te reja *ortaket kane te drejten e perparesis* ne nenshkrimin proporcionalisht me shumen e pjeseve te tyre.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj . Zvogelimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e Ortakeve . *Zvoglimi i kapitalit prek te gjithe ortaket* ne te njejten mase.

## Neni 8

Kapitali themeltar perbehet nga kontributet e meposhtme:

- |                 |                             |         |
|-----------------|-----------------------------|---------|
| 1 Shyqyrie GJKA | 50.000 leke (pesedhjetmije) | ose 50% |
| 2 Hane DODA     | 50.000 leke (pesedhjetmije) | ose 50% |

Ne te drejtat dhe detyrimet ortaket jane te barabarte .

## Neni 9

Ne baze te kontributeve te mesiperme :

- zn. Shyqyrie GJKA disponon *50 pjese* te kapitalit themeltar te renditura *nga numri 1 deri ne 50*  
zn. Hane DODA disponon *50 pjese* te kapitalit themeltar te renditura *nga numri 51 deri ne 100*

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar nenshkruhen plotesisht dhe pastaj shperndahen ndermjet ortakeve sipas ndarjes se mesiperme .

## Neni 10

Pjeset e kapitalit themeltar *jane lirisht te transferueshme* ndermjet ortakeve , ne rruge trashigimie .

Pjeset e kapitalit themeltar mund ti transferohen *te treteve* vetem *me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne 4/5 e pjeseve* dhe jo ne kushte me te favorshme se ato me te cilat i jane ofruar me pare ortakeve te tjere

### KREU III

## MARRJA E VENDIMEVE DHE KONTROLLI I SHOQERISE , ADMINISTRIMI

### Neni 11

Oratket e shoqerise *perballojne humbjet* e sajë deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Cdo ortak ka te drejte *te marre pjese ne mbledhjet dhe vendimet* e Asamblese vet ose nepermjet perfaqesuesit te tyre dhe disponon nje numer votash te barabart me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron . Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga nje ose disa ortakë qe zoterojne mbi 1/10 e pjeseve te kapitalit themeltar , nga Administratorei , nga ekspertet kontabel te autorizuar , po qe se ka te tille ose nga likujduesi.

Asambleja e zakonshme vendos per ceshnje te tilla si: emerimin ose shkarkimin e administratoreve , eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve , miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimin e llogarive vjetore dhe ndarjen e fitimit , etj .

Asamblese e jashtzakonshme vendos per ceshnje te tilla si; ndryshime te Statutit , zvogelimi i kapitalit themeltar , transferimin e kapitalit themeltar tek te tretet , zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo likuidimin e saj , shnderrimin e shoqerise nga S.H.P.K. ne nje forme tjeter te shoqerive tregtare .

### Neni 12

Administratore e shoqerise do te jete zn.**Shyqyrie G.JIKA** te ciles i jane besuar te gjitha plotefuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem , perjashtuar ato qe ligji dhe Statuti ia rezervojne Asamblese

Administratore i jepen te gjitha kompetencat te cilat ajo i pranon , per te kryer te gjitha formalitetet e themelimit . Ajo gjithashtu eshte e autorizuar te veproje ne emer te shoqerise qe do te krijohet deri ne regjistrimin e saj ne Gjykatën e Rrethit Tirane . Ajo eshte e paisur me mandat per te kryer akte dhe per te marre angazhime ne emer dhe per llogari te shoqerise. te cilat i kalojne shoqerise nga casti i regjistrimit .

Pervec te tjerave Administratorja eshte e ngarkuar te kryej akte dhe angazhime qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise dhe kompetencat e saj. Pas regjistrimit keto akte dhe angazhime i nenshtrohen miratimit te ortakëve jo me vone se data e mbledhjes se Asamblese qe shqyrton dhe vendos mbi llogaritë e vitit te pare financiar. Ky miratim ben automatikisht kalimin e ketyre akteve dhe angazhimeve ne ngarkim te shoqerise.

### Neni 13

Ne rast nevojë ose kur e kerkon ligji , kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar , i emruar per tre vite financiare me mundesi rrigjedhjeje.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar ashtu si edhe emerimi i tij vendoset me votimin e Asamblese , kur verehen gabime ose behet e pamundur kryerja e detyres .

## KREU IV

### VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMEVE

#### Neni 14

Viti i pare financiar fillon *nga data e regjistrimit* te shoqerise dhe *mbaron me 31 dhjetor 1998*.

Cdo vit tjeter financiar *fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor*.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga Administratore dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar, *miratohen nga Asambleja*.

Miratimi i bilancit vjetor behet *brenda 31 marsit te vitit pasardhes*.

#### Neni 15

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te ekzistences se fitimeve, Asambleja percakton pjesen qe u takon ortakëve ne formen e dividendeve mbi fitimin. Fitimi qe do te ndahet ndermjet ortakëve ne perpjestim me pjeset e kapitalit perbehet nga fitimi i vitit financiar te cilit i jane zbritur shumat e lena menjane *per fondin rezerve te domosdoshem (5% e fitimit te cdo viti deri sa ky fond te arrije vleren e 1/10 se kapitalit themeltar)* dhe nga ana tjeter te jene zbritur ose shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e udbartuara nga viti i meparshem.

## KREU V

### ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI I SHOQERISE

#### Neni 16

Zgjatja e afatit te veprimtarise se shoqerise *vendoset nga Asambleja*

#### Neni 17

Shoqeria mund te *priset* me perfundimin e afatit te percaktuar ne kete statut, me perjashtim te rasteve kur behet zgjatja e afatit sipas **neni 16** ose kur ka nje prishje te parakohshme per arsyt e parashikuara ne ligj

Shoqeria *nuk priset* kur njeri prej ortakëve falimenton, behet i paafte ose vdes.

#### Neni 18

Shoqeria *hyn ne procesin e likuidimit* qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e keti procesi

Asambleja *emeron* nje ose disa likuidues, te cilet i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit te saj, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e nevojshem te perfundimit te tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja vendos mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e regullshmerise se punes se likuiduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likuidimit

Mbas pagimit te kreditorëve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndermjet ortakëve proporcionalisht me pjeset e tyre ne kapitalin themeitar

## KREU VI DISPOZITAT E FUNDIT

### Neni 19



Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në një formë tjetër të shoqërive tregtare kryhet me vendim të Asamblesë së ortakëve QQ.

### Neni 20

Punësimi i punonjësve në shoqëri do të bëhet *mbi bazën e Kontrates Kolektive të Punës*. Në Kontraten Kolektive të Punës rregullohen keto çështje:

- \* kushtet dhe mënyra e marrëdhënies së punës ;
- \* fillimi i punës;
- \* koha e punës;
- \* mbrojtja në punë;
- \* të drejtat dhe detyrimet në punë;
- \* paga e punës, shpërblimi, etj.;
- \* pushimi i marrëdhënies së punës.

### Neni 21

Te gjitha *mosmarreveshjet* që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet shoqërisë dhe ortakëve gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit , do të zgjidhen *me mirkuptim* ndërmjet tyre dhe kur mirkuptimi nuk arrihet *organi kompetent* do të jetë Gjykata e Rrethit Bulqizë .

### Neni 22

Ky Statut është hartuar në Bulqizë më.....1998 , në katër ekzemplare origjinal duke patur fuqi të barabartë ligjore.

## ORTAKET

Shyqyrie GJIKA

Hane DODA